




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, pika d, neni 28, 29, 40, pika j të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 7 të Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.04.2023, merr këtë:

VENDIM

për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave përkatëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për iniciativën për Bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave përkatëse në fushën e Menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Neni 2

Bashkëpunim ndërkomunal do të zhvillohet ndërmjet komunave:

- 2.1 Komuna e Gjilanit;
- 2.2 Komuna e Ferizajit;
- 2.3 Komuna e Kamenicës;
- 2.4 Komuna e Vitisë;
- 2.5 Komuna e Kaçanikut;
- 2.6 Komuna e Hanit të Elezit;
- 2.7 Komuna e Shtimës;
- 2.8 Komuna e Shtërpçës;
- 2.9 Komuna e Klllokotit;
- 2.10 Komuna e Ranillukut;
- 2.11 Komuna e Novobërdës.
- 2.12 Komuna e Parteshit

Neni 3

Kryetari i Komunës dhe ekipi ndërkomunal (themeluar nga kryetari me Nr.02-035/02-861) janë të autorizuar të inicojnë dialogun dhe të punojnë së bashku në hartimin e planit të integruar ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave të indentifikojnë implikimet e mundshme financiare, duke përfshirë burimet financimit për zbatimin e duhur të planit. Kryetari i Komunës dhe ekipi ekzistues ndërkomunal mund të indentifikojnë gjithashtu implikime tjera të mundshme në lidhje me bashkëpunimin ndërkomunal në sektorin e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kërkesa e kryetarit të Komunës së Vitisë e arsyetuar për miratimin e iniciativës për bashkëpunimin ndërkomunal ndërmjet komunave përkaëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI

Bekim Azizi